

---

STATUTI DHE AKTI I THEMELIMIT I  
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
AXIOM ALBANIA SHPK

---

---

Tirane, me 08.03.2021

NENI 1  
THEMELIMI DHE EMRI I SHOQËRISË

- 1.1 Sot, më 08.03.2021, ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin "AXIOM ALBANIA" SH.P.K.
- 1.2 Themeluesit e shoqërisë janë:
- (i) Shoqëria "Axiom" SH.P.K, me seli ne adresen 'Zona Industriale Veternik, Prishtine' dhe e regjistruar ne Republiken e Kosoves më 09.03.2018 me numër unik identifikimi 810102202.
  - (ii) Z. Albi Beqiraj, shtetas Shqiptar lindur ne Tirane me 05.02.1988 mbajtes i letërnjoftimit me numër 033822578 dhe numër personal I80205064G.

NENI 2  
SELIA

- 2.1 Selia e Shoqërisë është në adresën: Rr. "Luigj Gurakuqi", Pallati 8, Shkalla 1, Nr 1, Tiranë, Shqipëri.
- 2.2 Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë për të transferuar selinë e Shoqërisë në një vend tjetër. Administratori i Shoqërisë ka të drejtë të hapë dhe të mbyllë degë dhe/ose zyra përfaqësimi në Shqipëri dhe jashtë saj.


NENI 3  
KOHËZGJATJA

- 3.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një kohëzgjatje të pacaktuar.

NENI 4  
OBJEKTI I AKTIVITETIT

- 4.1 Shoqëria ka si objekt të aktivitetit të saj kryerjen e të gjitha aktiviteteve që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të kryejë sipas ligjit shqiptar, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, përfshirë por pa u kufizuar në:
- a. Import - eksport, tregti me shumice dhe pakice e artikujve të parfumerisë, kozmetikes dhe tualetit ne dyqane te specializuara dhe nëpërmjet internetit.
  - b. Import - eksport, tregti me shumice dhe pakice e lodrave te ndryshme dhe artikujve te tjerë për fëmije ne dyqane te specializuara dhe nëpërmjet internetit.
  - c. Import – eksport, tregti me shumice dhe pakice produktesh te tjera te lejuara sipas ligjit shqiptar ne dyqane te specializuara dhe nëpërmjet internetit.
- 4.2 Shoqëria mund të ushtrojë veprimtarinë e saj në Shqipëri dhe jashtë saj e të kryejë çdo



D.D. <sup>2</sup> 

aktivitet tjetër të lidhur, ndihmës, të ngjashëm, plotësues apo të dobishëm për përmbushjen e objektit të saj. Me qëllim ndjekjen e objektit të veprimtarisë, Shoqëria:

- a) Mund të zotërojë pjesëmarrje në shoqëri të tjera, shqiptare apo të huaja, që kryejnë aktivitete të njëjta, të ngjashme apo të lidhura me aktivitetin e saj ose të subjekteve pjesëmarrëse;
- b) Mund të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme apo të dobishme me qëllim apo në lidhje me, përfshirë por pa u kufizuar në veprime me pasuri të luajtshme, të paluajtshme, tregtare dhe veprime të tjera të lidhura me objektin e aktivitetit të saj apo që mundësojnë një përdorim më të mirë të strukturave dhe/ose burimeve të veta apo të shoqërive dhe sipërmarrjeve në të cilat zotëron, drejtpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë, pjesëmarrje apo që i nënshtrohen kontrollit të përbashkët.

## NENI 5 KAPITALI THEMELTAR

5.1 Kapitali Themeltar fillestar i Shoqërisë është i barabartë me 100.000 Lekë, i ndarë në 2 (dy) kuota. Kapitali i Shoqërisë nënshkruhet tërësisht dhe paguhet nga ortakët themelues sipas kontributeve të mëposhtme:

- (iii) Ortaku shoqëria "Axiom" SH.P.K është zotëruar i 1 (një) kuote pjesëmarrje të barabartë me 86.000 Lekë, që perben 86% të kapitalit themeltar të Shoqërisë.
- (iv) Ortaku Z. Albi Beqiraj, është zotëruar i 1 (një) kuotë pjesëmarrjeje të barabartë me 14.000 Lekë, që perben 14% të kapitalit themeltar të Shoqërisë;

## NENI 6 TRANSFERIMI I KUOTAVE

6.1 Kuotat e kapitalit të Shoqërisë e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, sipas parashikimeve në kete statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

6.2 Kuotat e Shoqërisë mund të transferohen lirisht ndërmjet ortakëve. Premtimi dhe/ose transferimi i kuotave të Shoqërisë në favor të palëve të treta, në çdo formë, mënyrë apo afat, e drejta e opsionit dhe/ose krijimi i të drejtave të tjera mbi këto kuota i nënshtrohet

3  
D.D. Jule

të drejtës së parablerjes nga ortakët e Shoqërisë, e drejtë e cila do të ushtrohet në afatet dhe mënyrat e parashikuara në pikat e këtij neni si më poshtë. Perjashtim ben transferimi me ane të trashëgimisë i cili nuk i nënshtrohet të drejtës së parablerjes nga ortakët e Shoqërisë.

- 6.3 Në rast se një ortak ("Ofruesi") kërkon të shesë dhe/ose të transferojë kuotën e tij, ortakët e tjerë kanë të Drejtën e Parablerjes mbi kuotat e ofruara për transferim ("Kuotat e Ofruara"), në përputhje me kushtet dhe afatet e mëposhtme:
- 6.4 Ofruesi do t'u dërgojë fillimisht Ortakëve të tjerë një njoftim me shkrim me të dhëna të detajuara mbi identitetin e blerësit potencial, çmimin e kuotave të ofruara dhe kushtet e tjera materiale të transferimit ("Oferta");
- 6.5 Ortakët që marrin Ofertën, do të kenë të drejtën të blejnë Kuotat e Ofruara, me anë të një njoftimi me shkrim drejtuar Ofruesit brënda një afati 1 (nje) mujor nga data e marrjes së njoftimit.
- 6.6 Në rast se Ortakët e Mbetur që marrin Ofertën, e refuzojnë atë, ose në rast se oferta e tyre nuk përkon me kushtet e Ofertës brënda 1 (nje) muaji, e Drejta e Parablerjes e parashikuar në këtë nen do të konsiderohet automatikisht e parashkruar dhe Ofertuesi ka të drejtën t'i transferojë kuotat e ofruara çdo pale të tretë.
- 6.7 Nëse Ortaku/Ortakët e Mbetur që marrin ofertën, dështojnë t'i japin njoftimin e duhur Ofertuesit, do të merret e mirëqenë se Ortaku/Ortakët kanë refuzuar të blejnë kuotat e ofruara.
- 6.8 Në rast se Ortaku/Ortakët e mbetur vendosin të blejnë kuotën e ofruar, ortakët duhet që brenda 30 (tridhjetë) ditë pune, nisur nga dita e nesërme kur Ofertuesi ka marrë përgjigjen nga Ortaku/Ortakët e mbetur, të lidhin një marrëveshje të detyrueshme blerjesh së kuotave. Ortaku shitës është i detyruar të shesë kuotën e ofruar me çmimin e dhënë dhe sipas kushteve dhe afateve të parashikuara në ofertë.
- 6.9 Në rast se Ortakët nuk e kanë kryer marrëveshjen e blerjes së kuotave brënda afatit të parashikuar në paragrafin 6.8, procedura e ndjekur deri në atë moment për shitjen e kuotave, do të konsiderohet e pavlefshme dhe ortaku shitës duhet të nisë procedurën nga e para, siç është parashikuar në kete nen.

## NENI 7 ZMADHIMI I KAPITALIT

- 7.1 Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë. Në rastet kur vlerësimi për kontributet në natyrë nuk gjen kompromisin midis ortakeve, lind e drejta e kërkesës së emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti të autorizuar për keto kontribute.



4  
D.P. Jaku

- 7.2 Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

## NENI 8 ZVOGËLIMI I KAPITALIT TË SHOQËRISË


- 8.1 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të marrë me shumicën e cilësuar të parashikuar në këtë Statut. Në çdo rast, kapitali i Shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën kufirin e parashikuar me ligj.
- 8.2 Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

## NENI 9 ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME DHE ORGANET E SHOQËRISË

- 9.1 Asambleja e Përgjithshme është organi i vetëm vendimmarrës i Shoqërisë.
- 9.2 Asambleja e Përgjithshme vendos mbi të gjitha çështjet për të cilat është kompetente sipas legjislacionit shqiptar, këtij Statuti dhe/ose çdo marrëveshjeje tjetër ndërmjet ortakëve të Shoqërisë.
- 9.3 Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, të shprehë vullnetin e tij dhe të votojë sipas të drejtave që ka pjesëmarrja e tij në Shoqëri.
- 9.4 Çdo ortak mund të përfaqësohet nga një ortak tjetër ose nga një person i tretë i pajisur me autorizim me shkrim.
- 9.5 Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme mund të mbahen brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Ortakët ose përfaqësuesit e autorizuar mund të marrin pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme nëpërmjet mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencë dhe/ose videokonferencë, në përputhje me parashikimet e ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare dhe ligjin për komunikimet elektronike. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme do të quhet e mbajtur në vendin ku ndodhet Kryetari dhe Sekretari i mbledhjes, me qëllim që të hartohet dhe nënshkruhet procesverbali përkatës.
- 9.6 Asambleja e Përgjithshme thirret nga administratori ose ortakët e Shoqërisë, në përputhje me parashikimet e ligjit, dhe sa herë që thirrja është e detyrueshme sipas ligjit. Thirrja e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme duhet të bëhet nëpërmjet njoftimit me shkrim ose letërporosi, ose me postë elektronike të dërguar ortakëve në adresën e postës elektronike të ortakëve, të paktën 7 (shtatë) ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen e saj. Njoftimi i thirrjes duhet të përmbajë rendin e ditës,



5



vendin, datën dhe orën e mbledhjes. Asambleja e Përgjithshme do të mbledhet rregullisht në rast se, pavarësisht respektimit të formaliteteve të mësipërme, të gjithë ortakët apo përfaqësuesit e tyre janë dakord për rendin e ditës dhe të marrin vendime për çështjet përkatëse.

- 9.7 Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme kryesohen nga Kryetari, i zgjedhur midis të pranishmëve. Asambleja e Përgjithshme cakton një sekretar për çdo mbledhje midis personave të pranishëm.
- 9.8 Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të jenë me shkrim dhe të nënshkruhen nga Kryetari dhe Sekretari. Me kërkesë të ortakëve, vendimet duhet të përfshijnë dhe deklaratat apo vërejtjet e tyre.
- 9.9 Asambleja e Përgjithshme mbledhet të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar.
- 9.10 Asambleja e Përgjithshme, përveç sa parashikohet në nenin 9.11 të këtij Statuti, vendos me votën pro të shumicës së ortakëve të pranishëm, kur ortakët e mbledhur me të drejtë vote përfaqësojnë më shumë se 30% (tridhjetë për qind) të kapitalit të Shoqërisë.
- 9.11 Asambleja e Përgjithshme vendos me  $\frac{3}{4}$  e votave të ortakëve të pranishëm, kur ortakët e mbledhur me të drejtë vote përfaqësojnë më shumë se 50% (pesëdhjetë për qind) të kapitalit të Shoqërisë, për çështjet e mëposhtme:
- a) Ndryshimet e statutit;
  - b) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë;
  - c) Shpërndarjen e fitimeve;
  - d) Bashkimin, ndarjen, riorganizimin, prishjen dhe likuidimin e Shoqërisë.

## NENI 10 ADMINISTRIMI

- 10.1 Shoqëria do të administrohet dhe përfaqësohet nga një Administrator i Vetëm i zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme për një periudhë maksimale prej 5 (pesë) vjetësh. Administratori i Vetëm mund të rizgjidhet në detyrë ose të shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme.
- 10.2 Administratori i Vetëm gëzon të drejta të plota në lidhje me administrimin e Shoqërisë dhe mund të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm. Administratori mban përgjegjësi për veprimet e kryera gjatë administrimit të Shoqërisë dhe mund të delegojë të tretë për të kryer veprime dhe akte të caktuara, në emër dhe për llogari të Shoqërisë. Në çdo rast, administratori do të jetë përgjegjës për veprimet e të tretëve që ka autorizuar.



6  
D.D. Jula

- 10.3 Administratori i Vetëm vepron në respektim të politikave tregtare të përcaktuara nga Asambleja e Përgjithshme. Administratori do të veprojë në çdo kohë vetëm në interesin më të mirë të Shoqërisë.
- 10.4 Asambleja e Përgjithshme përcakton shpërblimin e Administratorit.
- 10.5 Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i parë i shoqërisë me nje mandat 5 vjecar:
- Z. Albi Beqiraj, shtetas Shqiptar lindur ne Tirane me 05.02.1988 mbajtes i letërnjoftimit me numër 033822578 dhe numër personal I80205064G.

#### NENI 11


##### VITI FINANCIAR, KONTROLI FINANCIAR DHE DIVIDENDI

- 11.1 Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.
- 11.2 Bilanci vjetor, pasqyrat financiare vjetore, raportet e Administratorëve dhe të Ekspertit Kontabël të Autorizuar (nëse është emëruar) miratohen nga Asambleja e Përgjithshme. Administratori është i detyruar t'i paraqesë për miratim Asamblesë së Përgjithshme raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe pasqyrat financiare vjetore.
- 11.3 Dokumentet që kanë të bëjnë me vitin financiar miratohen nga Asambleja e Përgjithshme brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar.
- 11.4 Kontrolli financiar i Shoqërisë kryhet nga Ekspertë Kontabël të Autorizuar, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. Asambleja e Përgjithshme do të emërojë një apo më shumë Ekspertë Kontabël të Autorizuar në të gjitha ato raste kur emërimi i tyre është i nevojshëm ose kërkohet nga ligji.
- 11.5 Ne përputhje me dispozitat e ligjit, Asambleja e Përgjithshme vendos për shpërndarjen e dividendit në bazë të rezultatit financiar të Shoqërisë. Fitimet do t'iu shpërndahen ortakëve përpjesëtimisht me kuotën që zotërojnë në Shoqëri.

#### NENI 12

##### DISPOZITA TË NDRYSHME

- 12.1 Në rast prishjeje dhe likuidimi të Shoqërisë do të zbatohen dispozitat e ligjit në fuqi.



- 12.2 Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me dispozitat ligjore, këtë Statut dhe marrëveshjet e ortakëve. Dispozitat e ligjit shqiptar në fushën e shoqërive tregtare do të zbatohen në rastet e paparashikuara nga ky statut.
- 12.3 Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet Shoqërisë, ortakëve dhe personave që tërheqin të drejta, organit administrues dhe Shoqërisë do të gjykohen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- 12.4 Ky Statut hartohet dhe nënshkruhet në 3 (tre) ekzemplarë të njëjtë në gjuhën shqipe.

Nënshkruar në Tiranë, më 08.03.2021.

ORTAKËT

Per Axiom SHPK

TAULANT REXHEPI

DAFINA DURMISHI



Albi Beqiraj

A handwritten signature in blue ink, written over a horizontal line.

8  
P.D. Jule